

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI

I KURSIT TË UNIFIKUAR

RIPARIM KOMPJUTERI

Kodi: PK-T-3-22

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2022

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“RIPARIM KOMPJUTERI”

(PK-T-2-22)

I. Profili profesional i riparuesve të kompjuterave.

a) Karakteristikat e riparuesve të kompjuterave

Riparuesi i kompjuterave personalë (desktop dhe laptop) kryen riparimin dhe mirëmbajtjen e hardware-ve dhe software-ve të kompjuterave personalë (desktop dhe laptop). Për realizimin e funksioneve të tij ai, në çdo rast ndjek një procedurë rigoroze të parapërcaktuar nga një specialist apo grup specialistësh të një niveli më të lartë.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, riparuesi i kompjuterave duhet që të zotërojë ***njohuri*** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe ***shprehi*** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të riparuesit të kompjuterave.

Suksesi i riparuesit të kompjuterave është i lidhur ngushtë dhe me ***sjellje*** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e riparuesve të kompjuterave

Riparuesit e kompjuterave mund të punësohen në njësi ose kompani të shërbimeve të kompjuterave, në institucione të ndryshme për mirëmbajtjen e kompjuterave, në njësi të shitjes së kompjuterave apo të vetëpunësohet për mirëmbajtje dhe riparim të kompjuterave.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë, riparuesi i kompjuterave mund të përparojë profesionalisht në nivelin e riparuesit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale, trajnimit në qendra të formimit profesional apo nëpërmjet punës, një riparues kompjuteri mund të ndër marrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i kompjuterave. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit për teknologji informacioni dhe komunikimi.

Për të zhvilluar aktivitet privat në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të kompjuterave, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në grupin “Instalues dhe specialist shërbimesh të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit”, me kod 7422, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Riparim kompjuteri”.

Në përfundin të Kursit për “Riparim kompjuteri”, kursantët do të jenë të aftë të:

- parapërgatisin vendin e punës;
- përzgjedhin veglat, instrumentat dhe materialet e duhura të punës;
- përdorin veglat e punës për riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterave personalë (desktop dhe laptop);
- kryejnë matje të parametrave elektronikë;
- analizojnë katalogët, manualët dhe dokumentacionin teknik të kompjuterave personalë;

- lexojnë dhe zbërthejnë skemat teknike të pajisjeve të ndryshme elektronike;
- zbatojnë skema të thjeshta me elemente elektronike;
- ndjekin instruksionet teknike të montimit dhe riparimit të pajisjes;
- zmontojnë dhe montojnë pjesët fizike të kompjuterave personalë;
- mirëmbajnë kompjuterat personalë;
- diagnostikojnë parregullsitë e kompjuterave personalë;
- riparojnë pjesët *hardware*-ike të kompjuterave personalë;
- riparojnë pjesët *software*-ike të kompjuterave personalë;
- çinstalojnë dhe instalojnë programe te kompjuterat personalë;
- testojnë funksionimin e kompjuterave personalë;
- të kryejnë lidhjen fizike të kompjuterit me pajisjet periferike;
- kryejnë përditësimin e sistemeve të operimit të kompjuterave;
- raportojnë në mënyre periodike te eprorët;
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e kryera;
- komunikojnë me etikë profesionale;
- zbatojnë rregullat e ruajtjes së privatësisë dhe të sigurisë kompjuterike;
- zbatojnë standardet ndërkombëtare që veprojnë në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Riparim Kompjuteri”.

Pjesmarrësit në Kursin për “Riparim kompjuteri” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Riparim kompjuteri”

360 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Riparim kompjuteri”

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet e të Nxënit
1	Hyrje në profesionin e riparuesit të kompjuterit	MK-26-324-22	80 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të riparuesit të kompjuterit. 2. Kursanti përshkruan konceptet dhe parimet bazë të elektroteknikës dhe elektronikës. 3. Kursanti realizon skema të thjeshta elektronike. 4. Kursanti interpreton dokumentacionin teknik të kompjuterit.

2	Zmontimi dhe montimi i kompjuterit personal	MK-26-325-22	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit zmontimin dhe montimin e kompjuterit personal. 2. Kursanti zmonton pjesët e kompjuterit personal. 3. Kursanti monton pjesët e kompjuterit personal.
3	Instalimi i programeve në kompjuter	MK-26-326-22	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti kryen instalimin dhe konfigurimin e sistemit operativ. 2. Kursanti instalon dhe çinstalon programet aplikative.
4	Riparimi dhe mirëmbajtja e kompjuterit personal	MK-26-327-22	100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti diagnostikon dhe riparon parregullsitë hardwarike të kompjuterit personal. 2. Kursanti diagnostikon dhe riparon parregullsitë softwarike të kompjuterit personal

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet e të Nxënës që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për “Riparim kompjuteri”

1. Moduli “Hyrje në profesionin e riparuesit të kompjuterit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E RIPARUESIT TË KOMPJUTERIT	MK-26-324-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të riparuesit të kompjuterit, konceptet dhe parimet dhe skemat bazë të elektroteknikës dhe elektronikës, me dokumentacionin teknik të kompjuterave personalë.	
Kohëzgjatja e modulit	150 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të riparuesit të kompjuterit. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përshkruajë funksionet dhe detyrat profesionale të riparuesit të kompjuterit;– të përshkruajë kushtet dhe mjedisin e punës së riparuesit të shërbimeve të kompjuterit;– të përshkruajë mjetet, instrumentet dhe materialet e punës së riparuesit të shërbimeve të kompjuterit;– të përshkruajë kërkesat profesionale të riparuesit të shërbimeve të kompjuterit;– të tregojë organizimin e punës në një biznes për riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterave personalë;– të argumentojë mundësitë e punësimit të riparuesit të shërbimeve të kompjuterit;– të rendisë mundësitë e karrierës profesionale të riparuesit të shërbimeve të kompjuterit;– të përshkruajë rregullat e ruajtjes së privatësisë dhe të sigurisë kibernetike në veprimtarinë e riparuesit të kompjuterave;– të zbatojë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët;– të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në riparimin dhe mirëmbajtjen e kompjuterave. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.	

RN 2 Kursanti përshkruan konceptet dhe parimet bazë të elektroteknikës dhe elektronikës.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë kuptimin e madhësive elektrike si rryma, tensioni, fuqia, rezistenca elektrike, kapaciteti, frekuenca etj.
- të përshkruajë burimet dhe llojet e rrymës elektrike
- të përshkruajë simbolet e rrymës “AC” dhe ”DC”;
- të përshkruajë përcjellësit dhe izolatorët;
- të përshkruajë efektet kryesore të rrymës elektrike;
- të përshkruajë dhe të përcaktojë elementët e një qarku elektrik të thjeshtë;
- të përshkruajë lidhjen në seri;
- të përshkruajë lidhjen në paralel dhe të përzier;
- të shpjegojë skemën bllok dhe të thjeshtë të një burimi ushqimi;
- të përshkruajë elementët elektronikë si dioda, tranzistori, tiristori, amplifikatori, procesori etj.;
- të përshkruajë dhe interpretojë shndërruesit A/C;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti realizon skema të thjeshta elektronike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përgatisë vendin dhe pajisjet e punës;
- të përzgjedhë sipas kërkesës dhe nevojës skemën e thjeshtë elektronike;
- të analizojë dhe interpretojë skemën e thjeshtë elektronike dhe komponentët e saj;
- të përzgjedhë drejtë komponentët e nevojshme të skemës;
- të përzgjedhë veglat dhe instrumentet e punës dhe ato matëse.
- të montojë drejt në panel përbërësit kryesorë elektronikë të skemës;
- të ngjisë siç duhet elementët elektronikë përbërës;
- të asamblojë drejtë komponentët e paraqitura në skemë;
- të lidhë siç duhet elementët elektronikë me njëri-tjetrin;
- të kryejë matjet e sakta të parametrave elektrikë me instrumentat përkatëse;
- të kryejë kontrollin e cilësisë së punës sipas rregullave teknike;
- të testojë funksionimin e rregullt të skemës së realizuar;
- të pastrojë dhe sistemojë veglat, mjetet dhe materialet mbas punimeve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RN 4 Kursanti interpreton dokumentacionin teknik të kompjuterit

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të lexojë dhe interpretojë dokumentacionin teknik dhe manualët e kompjuterave personalë (desktop dhe laptop);
- të interpretojë skemat dhe simbolet e përdorura në dokumentacionin teknik të kompjuterave;
- të shpjegojë bllok-skemën e kompjuterit;
- të interpretojë karakteristikat dhe parametrat teknike në manualët e instalimit, të përdorimit dhe të mirëmbajtjes së kompjuterave;
- të interpretojë informacionin e sigurisë vetjake në manualët orientuese;
- të interpretojë të dhënat e përgjithshme mbi rreziqet në manualët orientuese;
- të interpretojë kushtet e parapërdorimit dhe instalimit në manualët orientuese;
- të interpretojë kushtet e përdorimit dhe instalimit në manualët orientuese;
- të interpretojë të dhënat teknike mbi kursimin e energjisë dhe operimin optimal në manualët orientuese;
- të interpretojë kushtet e mirëmbajtjes dhe përdorimit në manualët orientuese;
- të interpretojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartet elektrike/elektronike dhe mjedise pune ku kryhen punime të riparimit të kompjuterave.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet e koncepteve kryesore të trajtuara dhe demonstrimet e proceseve të punës që përmban moduli.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Instruktori duhet të nxisë kursantët të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike dhe aftësive të fituara që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të nxënit.

**Kushtet e
e domosdoshme për
realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kabinet kompjuterik i pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Qarqe elektronike, pjesë të ndryshme elektrike, elektronike dhe kompjuterike .
- Video projektorë, tabela të gatshme të rregullave të sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit.
- Mjedise reale të punës për riparimin e pjesëve kompjuterike.
- Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për diagnostifikimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e kompjuterave.
- Skema elektronike, katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Zmontimi dhe montimi i kompjuterit personal”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ZMONTIMI DHE MONTIMI I KOMPJUTERIT PËRSONAL	MK-26-325-22
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson kursantët për të realizuar zmontimin dhe montimin e kompjuterit personal (desktop dhe laptop).	
Kohëzgjatja e modulit	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e riparuesit të kompjuterit”	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti parapërgatit zmontimin dhe montimin e kompjuterit personal Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të analizojë dokumentacionin teknik të kompjuterit (desktop ose laptop); – të analizojë drejt skemat dhe manualët e montimit; – të përzgjedhë mjetet dhe instrumentat e duhura të punës; – të përgatitë vendin e punës për zmontimin dhe montimin e kompjuterit personal; – të bëjë kontrollin pamor të kompjuterit personal; – të identifikojë pjesët që do të zmontohen dhe do të montohen në kompjuterin personal; – të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zmontimin dhe montimin e kompjuterit personal; – të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgimi me listë kontrolli. <p>RN 2 Kursanti zmonton pjesët e kompjuterit personal (desktop dhe laptop) Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> – të realizojë shkëputjen e kompjuterit nga rryma elektrike; – të pozicionojë kompjuterin për zmontim; – të bëjë kontrollin pamor të pjesëve që do të zmontohen; – të realizojë shkëputjen e pajisjeve periferike; – të zmontojë kasën e kompjuterit; – të bëjë pastrimin nga pluhurat të kompjuterit dhe pjesëve të tij; – të zmontojë baterinë (në rastin e laptopit). – të zmontojë bllokun e ushqimit nga kasa; 	

- të zmontojë *motherboard*-in nga kasa;
- të zmontojë ftohësin e procesorit nga *motherboard*-i;
- të zmontojë procesorin nga *motherboard*-i;
- të zmontojë kartat shtesë nga *motherboard*-i;
- të zmontojë harddiskun nga kasa;
- të zmontojë modulet e *RAM*-it nga *motherboard*-i;
- të zmontojë *driver*-at optikë nga kasa;
- të realizojë heqjen e kablllove përkatëse nga pjesët e kompjuterit;
- të sistemojë pjesët e zmontuara të kompjuterit;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 3 Kursanti monton pjesët e kompjuterit personal

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të konsultohet me manualin e kompjuterit;
- të pozicionojë kasën për montimin e pjesëve të kompjuterit;
- të montojë *motherboard*-in në kasë;
- të montojë bllokun e ushqimit në kasë;
- të montojë procesorin në *motherboard*;
- të montojë ftohësin e procesorit në *motherboard*;
- të montojë kartat shtesë në *motherboard*;
- të montojë modulet e *RAM*-it në *motherboard*;
- të montojë harddiskun në kasë;
- të montojë *driver*-at optikë në kasë;
- të montojë baterinë (në rastin e laptopit).
- të realizojë vendosjen e kablllove përkatëse në pjesët e kompjuterit;
- të montojë kasën e kompjuterit;
- të realizojë lidhjen e pajisjeve periferike;
- të vendosë pajisjet në rrymë elektrike;
- të kryejë matjet e duhura;
- të bëjë testimin e funksionimit të kompjuterit të montuar;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e praktikës.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për zmontimin dhe montimin e pjesëve

përbërëse të kompjuterit personal, si dhe kontrollin përfundimtar në ndezje.

- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për zmontimin dhe montimin e pjesëve përbërëse të kompjuterit si dhe kontrollin përfundimtar të tij.
- Ata duhet të praktikojnë përdorimin e manualëve dhe mjeteve për zmontimin dhe montimin e pajisjeve, si dhe të respektojnë standardet dhe rregullat e mbrojtjes në punë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedisi me bango dhe rafte për kryerjen e zmontimeve dhe montimeve të pjesëve të kompjuterit personal.
 - Pjesë të kompjuterit (bllok ushqimi, kasa, motherboard etj.)
 - Veglat dhe pajisjet e nevojshme (komplet kaçavidash, komplet pincash etj).
 - Instrumentat matës;
 - Materiale montimi (vida të përmasave të ndryshme, kablllo, fisha ushqimi).
 - Dokumentacioni teknik (manuale dhe udhëzuesa).
 - Pajisje të ndryshme periferike.
 - Materiale udhëzuese.
-

3. Moduli “Instalimi i programeve në kompjuter”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	INSTALIMI I PROGRAMEVE NË KOMPJUTER	MK-26-326-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të instaluar dhe konfiguruar sistemin e operimit dhe programet aplikative në kompjuterat personal (desktop dhe laptop).	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e riparuesit të kompjuterit”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1 Kursanti kryen instalimin dhe konfigurimin e sistemit operativ. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">– të analizojë manualin e kompjuterit personal (desktop ose laptop);– të përcaktojë karakteristikat e kompjuterit personal;– të zgjedhë versionin e duhur të sistemit operativ bazuar mbi karakteristikat e <i>hardware</i>-ve të kompjuterit;– të përcaktojë mënyrën e particionimit të harddiskut;– të vendosë median e instalimit në drajvin e zgjedhur;– të përcaktojë radhën e boot-imit në <i>BIOS</i>;– të ristartojë kompjuterin;– të lexojë dhe pranojë kushtet e licencës;– të particionojë harddiskun;– të përgjedhë particionin C për instalimin e sistemit të operimit;– të zgjedhë sistemin e duhur të skedarëve;– të caktojë dosjen e instalimit;– të japë informacione rreth përdoruesve;– të përzgjedhë rajonin dhe gjuhën;– të vendos <i>product key</i> (nëse ka);– të emërtojë kompjuterin dhe të vendos fjalëkalimin e administratorit;– të vendosë orën dhe datën e saktë;– të kontrollojë funksionimin e sistemit operativ pas instalimit;– të shkarkojë dhe instalojë përditësimet e nevojshme;– të shkarkojë dhe instalojë <i>driver</i>-t e nevojshëm.– të përshtasë paraqitjen e <i>desktop</i>-it (ngjyrën e sfondit, rezolucionin, simbolet etj.);– të ri-startojë kompjuterin duke testuar funksionimin e sistemit operativ në kompjuter.	

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RN 2 Kurtanti instalon dhe çinstalon programet aplikative.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë manualin e kompjuterit personal (desktop ose laptop);
- të përcaktojë karakteristikat e kompjuterit personal;
- të përzgjedhë llojet e programeve aplikative me/pa pagesë sipas nevojës së përdoruesit;
- të evidentojë kërkesat minimale të parametrave *hardware* që kërkon programi aplikativ (parametrat e *RAM*, *HDD*, *procesorit etj.*)
- të zgjedhë versionin e duhur të programit aplikativ bazuar mbi versionin e sistemit të operimit në kompjuter;
- të përzgjedhë median e instalimit (*USB*, *CD* ose *DVD*).
- të shkarkojë programet aplikative nga faqet zyrtare të tyre;
- të kontrollojë programet aplikative të instaluara në kompjuter nëse përbëjnë konflikt me programin që do të instalohet.
- të çinstalojë programet aplikative nëse është e nevojshme duke ndjekur hapat e nevojshme në varësi të sistemit të operimit.
- të ndjekë hapat e instalimit sipas udhëzimeve përkatëse në faqen zyrtare ose të manualit të programit aplikativ.
- të konfigurujë mjete shtesë nëse është e nevojshme.
- të zgjedhë folderin e ruajtjes së programit.
- të konfigurujë specifikime në program sipas preferencave të përdoruesit.
- të testojë instalimin e programit aplikativ në kompjuter.
- të kryejë llogaritjet ekonomike për punën e kryer.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në laboratorin e praktikës.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për instalimin e sistemeve operative, konfigurimin e tyre, instalimin e programeve aplikative.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për instalimin e sistemeve operative dhe aplikative. Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në

	<p>këtë modul.</p> <ul style="list-style-type: none"> – Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.
<p>Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit</p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Dokumentacioni teknik i kompjuterit personal (manuale dhe udhëzuesa). – Mediat e instalimit të sistemeve operative (USB,CD/DVD) – Lidhje në Internet. – Manuale instalimi të sistemeve operative dhe aplikative. – Materiale udhëzuese.

4. Moduli “Riparimi dhe mirëmbajtja e kompjuterit personal”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kod	RIPARIMI DHE MIRËMBAJTJA E KOMPJUTERIT PERSONAL.	MK-26-327-22
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të kryer shërbime të riparimit dhe të mirëmbajtjes së <i>hardware</i> -ve dhe <i>software</i> -ve, të kompjuterit personal (desktop dhe laptop).	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e riparuesit të kompjuterit”.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RN 1 Kursanti diagnostikon dhe riparon parregullsitë <i>hardware</i>-ike të kompjuterit personal. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të analizojë manualin e kompjuterit personal (desktop ose laptop); – të përcaktojë karakteristikat e kompjuterit personal; – të përzgjedhë veglat dhe instrumentat e punës. – të çmontojë kompjuterin personal <i>Desktop</i>. – të kryejë matjet dhe kontrollet e duhura. – të diagnostikojë parregullsitë hardwarike në kompjuterat personal <i>Desktop</i> – të listojë elementët e nevojshëm për riparim në kompjuterat personal <i>Desktop</i> – të përzgjedhë elementët e duhur për riparim në kompjuterat personal <i>Desktop</i>. – të përcaktojë procedurën për riparimin e parregullsive hardwarike në kompjuterat personal <i>Desktop</i>. – të riparojë parregullsitë hardwarike (zëvendësimin e pjesëve) në kompjuterin personal <i>Desktop</i>. – të montojë kompjuterin personal <i>Desktop</i>. – të testojë riparimet e kryera në kompjuterin personal <i>Desktop</i>. – të çmontojë kompjuterin personal <i>Laptop</i>. – të kryejë matjet dhe kontrollet e duhura. – të diagnostikojë parregullsitë hardwarike në kompjuterat personal <i>Laptop</i>. – të listojë elementët e nevojshëm për riparim në kompjuterat personal <i>Laptop</i> – të përzgjedhë elementët e duhur për riparim në kompjuterat personal <i>Laptop</i> – të përcaktojë procedurën për riparimin e parregullsive hardwarike në kompjuterat personal <i>Laptop</i> 	

- të riparojë parregullsitë hardwarike (zëvendësimin e pjesëve) në kompjuterin personal *Laptop*.
- të montojë kompjuterin personal *Laptop*.
- të testojë riparimet e kryera në kompjuterin personal *Laptop*.
- të kryejë llogaritjet ekonomike për punën e kryer.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë.
- Vëzhgimi me listë kontrolli.

RN 2 Kursanti diagnostikon dhe riparon parregullsitë softwarike të kompjuterit personal.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë manualin e kompjuterit personal (desktop ose laptop);
- të përcaktojë karakteristikat e kompjuterit personal;
- të përzgjedhë veglat dhe instrumentat e punës.
- të kryejë matjet dhe kontrollet e duhura.
- të diagnostikojë parregullsitë softwarike në kompjuterat personal *Desktop*
- të listojë të gjithë hapat e nevojshëm për zgjidhjen e parregullsive softwarike në kompjuterat personal *Desktop*.
- të riparojë parregullsitë softwarike hap pas hapi, në kompjuterat personal *Desktop*
- të diagnostikojë parregullsitë softwarike në kompjuterat personal *Laptop*
- të listojë të gjithë hapat e nevojshëm për zgjidhjen e parregullsive softwarike në kompjuterat personal *Desktop*
- të riparojë parregullsitë softwarike hap pas hapi, në kompjuterat personal *Laptop*
- të instalojë licensat e nevojshme, në rast ndryshimi të versionit të një programi softwarik
- të testojë funksionimin e programeve softwarike, pas riparimit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgimi me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në laborator kompjuterash, ku të ketë kompjutera personal *Desktop* dhe *Laptop*
- Instruktori duhet të ilustrojë dhe të demonstrojë sa më shumë të jetë e mundur mënyrën e diagnostikimit të parregullsive *hardwarike* në kompjuterat personal *Desktop* dhe *Laptop*
- Instruktori duhet të ilustrojë dhe të demonstrojë sa më shumë të jetë e mundur mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të kryejë llogaritjet ekonomike për punën e kryer.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të mbrojtjes së mjedisit në kompjuterat personal *Desktop* dhe *Laptop*

-
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për diagnostifikimin dhe riparimin e parregullsive në kompjuterat personal *Desktop* dhe *Laptop*
 - Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës që kryejnë.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të shprehive të fituara.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të nxënit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedisi pune për kryerjen e diagnostifikimin dhe riparimin e parregullsive hardwarike dhe softwarike;
 - Udhëzues, rregullore, manuale teknike, skedë teknike, materiale të shkruara në mbështetje të zbatimit të modulit etj.
-